



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

Zyra e Auditorit Gjeneral/ Kancelarija Generalnog Revizora/ Office of the Auditor General

Nr.i dokumentit : 21.2.1 – 2007 - 08

RAPORTI FINAL I AUDITIMIT PËR
PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË
KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2007

Prishtinë, Gusht 2008

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. Përmbledhje e përgjithshme
 - II. Hyrje
 - III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar
 - IV. Fushëveprimi i auditimit
 - V. Opinioni i auditimit
 - VI. Qasja e auditimit
 - VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit
 - 1. Pasqyrat financiare
 - 2. Procedura jo te rregullta te rekrutimit te stafit
 - 3. Shpenzimet telefonike
 - 4. Procedurat e prokurimit
 - 5. Shpenzimet e udhëtimit
 - 6. Menaxhimi i pasurisë
 - 7. Menaxhimi i automjeteve
 - 8. Menaxhimi i parasë se imët
- Aneksi 1 Pasqyrat Financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007

LISTA E SHKURTESAVE DHE FJALËVE

AGJ	Auditori Gjeneral
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral
ZKM	Zyra e Kryeministrit
SIMFK	Sistemi Informativ Menaxhimit të Financave të Kosovës

I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007.

Në mendimin tonë, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të ZKM -së dhe rezultatet e aktiviteteve të saja për vitin në fjalë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik sipas “ Raportimit Financiar në Bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe përfshinë testimet dhe procedurat e tilla që ne i kemi konsideruar të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë ka identifikuar këto tetë të gjetura kryesore të auditimit:

1. Pasqyrat financiare nuk kanë përfshirë të hyra vetanake;
2. Procedura jo të rregullta të rekrutimit të stafit;
3. Shkelje e Udhëzimit Administrativ 2006/08 për shpenzime telefonike;
4. Prokurime të paautorizuara dhe moszbatim i ligjit të prokurimit;
5. Shpenzime udhëtimi pa urdhëresa udhëtimi dhe për persona që nuk janë të punësuar në ZKM;
6. Inventarizim i pjesshëm i pasurisë për vitin 2007;
7. Menaxhim joadekuat i automjeteve;
8. Menaxhim joadekuat i parasë së imtë;

Ne rekomandojmë që menaxhmenti të adresojë këto të meta kryesore, për të përmirësuar nivelin aktual të kontrollit të brendshëm brenda organizatës.

II. HYRJJE

Zyra e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) të Kosovës është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/18 të datës 4 tetor 2002. Sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje Auditori Gjeneral (AGJ), ndër të tjera, është i thirrur që ta kryejë auditimin vjetor të rregullsisë për të gjitha institucionet në Kosovë qoftë për ato në pronësi publike apo për ato që marrin mjete financiare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividendë, apo të hyra të tjera jo tatimore për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Neni 1 i kësaj rregulloreje përkufizon auditimin e rregullsisë si verifikim i përgjegjësisë financiare duke përfshirë ekzaminim dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe shprehjen e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të marra nga institucioni ose subjekti që iu është nënshtruar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo lidhen me auditimin;

Në muajin mars të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës ka miratuar “Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” Nr. 2003/2 (LMFPP), i cili edhe formalisht është shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/17 të datës 12 maj 2003. Neni 42 i këtij ligji thekson që AGJ duhet të përgatisë dhe t’i dorëzoj Kuvendit dhe PSSP-së një raport lidhur me pasqyrat financiare të organizatave buxhetore për vitin e kaluar, ku AGJ jep opinionin e saj nëse pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të financave të organizatave të tilla buxhetore. Ky raport duhet të dorëzohet më 30 qershor duke pasuar përfundimin e vitit fiskal të cilit i referohet raporti vjetor.

III. GJENDJA LIDHUR ME REKOMANDIMET NGA VITI I KALUAR

Auditimi i ZAGJ-së mbi pasqyrat financiare të ZKM -së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2006 kishte rezultuar me 15 rekomandime të auditimit. Auditimi ynë i tanishëm ka përcaktuar që ZKM -ja ka zbatuar 7 nga këto rekomandime dhe se është në proces të zhvillimit të politikave dhe procedurave përkatëse për zbatimin e rekomandimeve të mbetura. Ne kemi vërejtur se shumica e rekomandimeve të prokurimit nga viti i kaluar janë zbatuar.

IV. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

ZAGJ ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007. ZKM funksionon në bazë të Rregullores së UNMIK – ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, dhe me Rregulloren e UNMIK – ut nr. 2005/15 që Ndryshon Rregulloren e UNMIKU–ut Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Objektivë primare e këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAGJ-së të shprehë opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të ZKM -së japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për të hyrat e arkëtuara dhe shpenzimet e bëra gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2007, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) mbi "Rraportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". SNKSP-të janë nxjerr nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (BSNASP) i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK). Saktësia dhe plotësia e pasqyrave financiare si dhe shkresat shoqëruese të dhëna në aneksin 1, janë përgjegjësi e menaxhmentit të ZKM-së.

V. OPINIONI I AUDITIMIT

Gjatë Auditimit janë identifikuar mangësi serioze në kontrollet e brendshme të ZKM-së dhe ka përcaktuar se nuk mund të mbështeteshim në këto kontrolle. Testimet substanciale kanë shpalosur se ZKM nuk ka zbatuar rregulloret aktuale dhe udhëzimet administrative që janë në fuqi, duke ndikuar edhe më tej në mënyrë negative mbi drejtësinë, besueshmërinë dhe plotësinë e pasqyrave financiare.

Në mendimin tonë, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të ZKM-së më 31 dhjetor 2007 dhe rezultatet e aktiviteteve të saja për vitin në fjalë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik sipas "Raportimit Financiar në Bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme".

VI. QASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të ZKM - së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007, është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të hartuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë. Bordi funksionon si një organ përcaktues për standardet ndërkombëtare, nën patronazhin e FNK-së. SNA-të vendosin kornizën ndërkombëtare në kuadër të cilës ZAGJ kryen aktivitetin e saj dhe mbulon çështjet si parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rreziqeve dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve si dhe konkluzionet dhe raportimi mbi auditimin.

Auditimi ynë ishte planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 25.03.2008 deri 29.04.2008. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisve tona, ne:

- Kemi rishikuar pasqyrat financiare të ZKM - së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2007;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të ZKM-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP-të “ Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
- Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në kuadër të ZKM - së, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë ;

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e tjera të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Ka të ngjarë që informata shtesë mund të kenë ekzistuar, informata të cilat nuk na janë siguruar, të cilat po të na siguroheshin do të kishin mundur të ndryshonin të gjeturat tona të auditimit.

Sa i përket opinionit të auditimit të ZAGJ-së lidhur me pasqyrat financiare të, ZKM –së, SNA definojnë kriteret specifike të cilat përcaktojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinioni i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit. Për shembull, ZAGJ mund të mos jetë në gjendje të japë një opinion të pakualifikuar kur ekzistojnë cilado prej rrethanave vijuese dhe sipas gjykimit të ZAGJ-së efekti i çështjes është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

(a) Kur ka kufizim të fushëveprimit të punës së auditorit;ose

(b) Kur ka mosmarrëveshje me menaxhmentin lidhur me pranueshmërinë e politikave të zgjedhura kontabël, metodën e aplikimit të tyre ose përshtatshmërinë e shpalosjeve të pasqyrave financiare.

Rrethanat e përshkruara nën (a) mund të shpijnë në opinionin e kualifikuar ose në mohimin e opinionit. Rrethanat e përshkruara nën (b) mund të shpijnë në opinionin e kualifikuar ose në opinionin kundërt.

Një opinion i kualifikuar në përgjithësi lëshohet atëherë kur ZAGJ konstaton se nuk mund të lëshohet një opinion i pakualifikuar, porse efekti i ndonjë mosmarrëveshjeve me menaxhmentin ose kufizimi i fushëveprimit nuk është aq material dhe i përhapur sa të kërkojë dhënien e një opinionit të kundërt ose mohim të opinionit.

Mohim i opinionit do të jepet atëherë kur efekti i mundshëm i kufizimit në fushëveprim është aq material dhe i përhapur sa që ZAGJ nuk ka mundur të siguroj dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit dhe rrjedhimisht nuk mund të lëshoj opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Një opinion i kundërt do të lëshohet atëherë kur efekti i mosmarrëveshjes është aq material dhe i përhapur në pasqyrat financiare për çka dhe ZAGJ konstaton se kualifikimi i raportit nuk është i përshtatshëm për të shpalosur natyrën e çorientuar ose jo të plotë të pasqyrave financiare.

VII. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KYÇE

Më poshtë kemi paraqitur të gjeturat dhe rekomandimet kyçe:-

1. Pasqyrat Financiare

Pasqyrat Financiare (PF) duhet të përgatiten nga secili entitet i pavarur, bazuar në regjistrat e vet kontabël dhe në atë mënyrë që të paraqesin përgjegjshmëri dhe transparencë në shfrytëzimin e parasë publike. Formatit i tyre kërkon shpalosje dhe shpjegime shtesë në formë të Shënimeve, që siguron informacion për lexuesit.

Ligji Nr. 2003/2 “Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë” rregullon përgatitjen dhe harmonizimin e pasqyrave financiare të të gjitha organizatave buxhetore.

Në mënyrë që të zbatohet Ligji Nr. 2003/2, duhet që:

- Drejtori Financiar i organizatës buxhetore duhet që në afat prej tridhjetë ditësh nga përfundimi i çdo viti fiskal, t’i siguroj Drejtorit të Thesarit (i) një kopje të pasqyrave financiare (ii) konfirmimin që pasqyrat financiare janë një prezantim i vërtetë dhe i saktë i financave dhe transaksioneve financiare gjatë vitit në fjalë.
- Drejtori i Thesarit duhet që, brenda nëntëdhjetë ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal (i) të harmonizoj llogaritë financiare të pranuar me llogaritë fiskale dhe gjendjen e parasë dhe (ii) t’i sigurojë llogaritë financiare të të gjitha organizatave buxhetore Auditorit Gjeneral për auditim.

Këto pasqyra financiare duhet të përgatiten duke u bazuar në regjistrat kontabël që duhet të mbahen për çdo organizatë buxhetore, siç përcaktohet me sa vijon me Ligjin Nr. 2003/2:

- Të hyrat e organizatës buxhetore;
- Detyrimet e papaguara të organizatës buxhetore;
- Pasuritë (asetet) e organizatës buxhetore;
- Përvetësimet;
- Ndryshimet e përvetësimeve;
- Përvetësimet që janë vënë në dispozicion të organizatës buxhetore për shpenzime përmes njoftimeve për fondet e alokuara;
- Niveli deri te i cili fondet e alokuara të organizatës buxhetore janë regjistruar si fonde të zotuar; dhe
- Shpenzimet reale të bëra.

Pasqyrat Financiare duhet të përgatiten në përputhje me UA të MEF-t nr. 2007/08 “Raportimi vjetor i organizatave buxhetore”

E gjetura

Pasqyrat Financiare të ZKM-së paraqesin të hyra në vlerë prej 28.188 Euro, prej tyre 22.314 Euro nga gazeta zyrtare dhe 5.873 Euro nga telefoni. Ndërsa nga të dhënat e thesarit kemi vërejtur se të hyrat e ZKM –se janë 29.363 Euro, prej tyre 838 Euro prej gazetës zyrtare, 7.048 Euro prej pranimeve tjera dhe 21.487 Euro nga të hyrat ndër-departmentare.

Gjatë punës në terren kemi vërejtur se nuk janë përfshirë në pasqyrat financiare, ose janë përfshirë në kode tjera të të hyrave:

- Të hyrat e Arkivës së Kosovës – nga Qiraja 19,200 Euro dhe të hyra nga palët 969 Euro, në total 20,169 Euro.
- Shitja e veturave – 2,736 Euro.

Konkluzioni

Fakti që ka të hyra që nuk janë të përfshira në PF të ZKM-së, lë të kuptohet që këto pasqyra nuk janë të plota dhe të sakta.

Rekomandimi nr.1.

ZKM duhet të përfshijë të gjitha të hyrat në pasqyrat e saj financiare.

Komentet e Menaxhmentit

Të hyrat në pasqyrat financiare janë përpiluar në bazë të arkëtimeve të realizuara gjatë vitit 2007, dhe të cilat janë të evidentuara në SIMFK. Me rastin e themelimit të Zyrës së Gazetës Zyrtare, të hyrat fillimisht janë evidentuar në klasën e gjashtë, deri në vlerën prej 828.00 euro. Më vonë nga ana SIMFK kemi marrë raportin e evidentuar në klasën e pestë, me këtë rast ne kemi marrë raportin me të hyrat me vlerë më të vogël prej 828.00 .Kurse në fondin e BKK-së janë të evidentuara edhe të hyrat në vlerën e cekur.

Arkëtimet nga shitja e pasurisë (automjeteve) e cila është bërë në bazë të Udhëzimit Administrativ të MEF-it nr. 2005/11, në vlerë prej 2.736.00, derdhen në BKK e nuk mund të përdoren ato mjete si të hyra të Organizatës Buxhetore.

Të hyrat e Arkivit të Kosovës të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare 2007, nuk kanë figuruar në raportin e SIMFK-së dhe nuk kanë mundur të pasqyrohen në raport si të hyra të arkëtuara, pasi që evidenca mbahet në bazë të pagesave të realizuara e jo vetëm të kalkuluara.

Vlerësimi i ZAGJ – se

Mbeten konstatimet e auditorit në raport pasi që në raport është paraqitur diferenca në mes të raportimeve sipas Librit kryesor të Thesarit dhe pasqyrave financiare të ZKM -së, e për këto konstatime i kemi si dëshmi të dhënat e thesarit dhe pasqyrat financiare të ZKM –se. Për të hyrat e Arkivit të Kosovës kemi testuar të gjitha kontratat e tyre dhe gjatë kalkulimit për çdo muaj kemi ardhur në përfundim se të hyrat prej kontratave nga qiraja duhet të jene 19.200. Zyrtaret e Arkivit nuk e kanë përcjell realizimin e këtyre të hyrave dhe nuk janë në dijeni se a realizohen këto të hyra. Sipas tyre të hyrat realizohen në thesar.

2. Procedura jo të rregullta të rekrutimit të stafit

Rekrutimi i të punësuarve është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ MSHP / DASHC / 2003/01 “Procedurat e rekrutimit” për zbatimin e Urdhëresës Administrative 2003/2 – zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.

Sipas këtij udhëzimi, së pari bëhet kërkesa nga Shefi i Sektorit përkatës, kjo kërkesë i dërgohet Menaxherit të Personelit dhe pastaj kërkohet miratimi prej Sekretarit të Përhershëm. Nëse kërkesa miratohet atëherë përgatitet shpallja për konkurs, caktohet komisioni i përzgjedhjes, caktohen kriteret e përzgjedhjes, mbahen intervistat dhe përgatitet një raport për përzgjedhjen dhe rekrutimin.

E gjetura

Gjate vitit 2007 janë pranuar gjithsej 17 te punësuar, ndërsa ne kemi testuar 3 dosje nga ky grup i të punësuarve.

Sipas testimave që janë bërë, është vërejtur se te punësuarit janë pranuar ne punë pa kritere ku fillimisht atyre ju është bërë kontratë e përkohshme për 3 muaj. Pas kësaj periudhe është shpallur konkursi për të njëjtat pozita dhe pas zbatimit të të gjitha procedurave, të njëjtit të punësuar që punonin me kontratë të përkohshme janë emëruar në pozitat e shpallura. Kjo ka ardhur si rezultat i keq menaxhimit sa i përket procedurave te rekrutimit te të punësuarve.

Konkluzioni

Te punësuarit pa procedura te rekrutimit me kontrata te përkohshme mund te ndodhë të jenë persona të cilët nuk kanë kualifikimet përkatëse ose përvojën e mjaftueshme që të punësohen në pozitat e shpallura.

Rekomandimi nr.2.

Procesi i rekrutimit duhet të jetë sa më transparent që është e mundur, që nënkupton se i tërë procesi duhet të jetë në zbatim të UA për rekrutimin e personelit.

Komentet e Menaxhmentit

Pajtohemi me të gjeturën e zyrtarëve të auditimit të jashtëm lidhur me rekomandimin për një proces sa më transparent që është e mundur. Rastet e ekzaminuara kanë të bëjnë me tre pozita, një –tek Agjencia për Integritet Evropian dhe dy- te Agjencia për Barazi Gjinore.

Një gjë e tillë është bërë fillimisht me kërkesën gojore të kryeshefave të dy agjencioneve, duke u arsyetuar në vëllimin e punëve dhe në urgjencën që të punësohen personat të cilët më pas do t'i nënshtrohen procedurave të rregullta të rekrutimit. Kështu edhe është vepruar më pas, është shpallur konkursi dhe janë përzgjedhur kandidatët që i kanë plotësuar kriteret e kërkuara me konkurs. Edhe përkundër insistimit të zyrtarëve të personelit që të barten të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë te dy agjencitë e lartshënuara kjo ende nuk ka ndodhur. Lidhur me parregullsitë e gjetura përgjegjësia bie mbi kryeshefat ekzekutivë të dy agjencive.

Në takimi me Sekretarin e Përhershëm lidhur me zbatimin e Urdhresës Administrative nr.2003/2 për zbatimin e rregullores 2001/36 pas rekomandimeve të marrura nga Auditimi, Sekretari kërkoi zbatim të plotë të rregullave dhe procedurave të rekrutimit të stafit në pajtim me ligjin.

Vlerësimi i ZAGJ – se

Entiteti është pajtuar me të gjeturën, andaj mbeten konstatimet e auditorit ne raport.

3. Shpenzimet Telefonike

Udhëzimi Administrativ (UA) 2006/08, Neni 10, Masat në Rritjen e Efikasitetit të Administratës Publike, vendos limitet e shpenzimeve për telefona mobil dhe fiks. Ky UA përcakton se kush ka të drejtë të shfrytëzoj telefonin dhe po ashtu vendos limitet e shpenzimeve të lejueshme.

E gjetura

Shpenzimet e përgjithshme telefonike për vitin 2007 ishin 201,118 Euro. Sipas pasqyrave financiare 167,612 Euro janë për kabinetin e Kryeministrit dhe Departamentin Administratës.

Shpenzimet ishin më të larta se që është e lejuar sipas UA 2006/08; për telefona fiks janë shpenzuar 24,839 Euro më shumë, ndërsa për telefonat me parapagim është shpenzuar më shumë për 17,120 Euro, marrë së bashku shuma e mbi shpenzuar arrin vlerën në 41,959 Euro.

Konkluzioni

Dështimi për të kontrolluar shpenzimet telefonike ka rezultuar me mbishpenzim të buxhetit të ZKM-së.

Rekomandimi nr. 3.

Rekomandojmë që menaxhmenti të ndërmerr masa për të kontrolluar shpenzimet telefonike, duke aplikuar rregullat e UA 2006/08.

Komentet e Menaxhmentit

Pajtohem me konkluzionin e zyrtarëve të auditimit lidhur me mbishpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile. Ky tejkallim i shpenzimeve ka ndodhur për arsye të funksionalizimit dhe përmbushjes me sukses të detyrave të punës. Kjo është edhe si rezultat i asaj se me UA nr. 08/2006 nuk janë paraparë limitet e nevojshme për fusha të ndryshme me rëndësi të veçantë. Përdorimi i telefonisë fikse sipas këtij udhëzimi në shumë raste shkakton pengesë në realizimin dhe përmbushjen e detyrave të punës dhe mund të vë në rrezik përmbushjen e mandatit të zyrës. Megjithatë, ka pasur edhe tejkallime të paarsyeshme. Lidhur me shpenzimet dhe tejkallimet për çdo muaj janë bërë raporte me shkrim.

Tani më që është në fuqi UA nr. 04/2008, janë duke u marr masa që të respektohet në përpikëri ky UA ose në të kundërtën do të merren masa që çdo tejkallim i shpenzimeve do të arsyetohet ose do të ndëshkohen përmes ndalesës nga paga për aq sa janë tejkalluar shpenzimet.

Vlerësimi i ZAGJ – se

Entiteti është pajtuar me te gjeturën, andaj mbeten konstatimet e auditorit ne raport.

4. Procedurat e Prokurimit

Qëllimi i Ligjit mbi Prokurimin Publik (LPP) 2003/17 është që të siguroj që subjektet publike në Kosovë shfrytëzojnë fondet dhe resurset publike në mënyrën më efikase, transparente dhe ekonomike, duke marr në konsideratë qëllimin dhe synimin e prokurimit.

E gjetura

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur një shkallë të përmirësimit në menaxhimin e procedurave të prokurimit. Megjithatë, ende ekziston një numër i të metave, shembuj të të cilave janë të paraqitura në vijim:

- Buxheti për blerje të pajisjeve gjatë vitit 2007 ishte 12,000 Euro, mirëpo shuma e shpenzimeve për këtë qëllim ishte 155,922 Euro, një diferencë prej 143,922 Euro. Ne kemi hasur në disa raste kur mallrat nuk janë pranuar sipas specifikacionit teknik.
- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative (TI), 55,645 Euro;- ne kemi vërejtur se disa pajisje të blera ishin deponuar dhe nuk ishin shpërndarë. Gjatë vizitës sonë të datës 14.04.2008, ne kemi vërejtur se 7 muaj pas datës së blerjes së 2 video projektorëve, 6 skanerëve, 1 makine fotokopjuese, 6 faks makinave, 2 kompjuterëve dhe 3 fotoaparateve, këto pajisje ende nuk ishin futur në përdorim.
- Katër automjete të blera me një shumë totale prej 201,996 Euro; specifikacioni teknik nuk ishte përgatitur nga njësi përkatese profesionale (njësia e transportit) por nga Zyra e Prokurimit. Komisioni i Vlerësimit i përbërë nga Shefi i Kabinetit, Zyrta i Prokurimit dhe Koordinatori për Çështje Ekonomike, është dashur megjithatë të ketë edhe një profesionist teknik.

Konkluzioni

Çmimi ekzistues i pajisjeve ka tejkaluar çmimin e buxhetuar, duke krijuar një mbishpenzim shumë të lartë, që na bënë të konstatojmë se nuk ka pasur një kontroll adekuate në lidhje me prokurimet.

Blerja e pajisjeve të panevojshme ndikon negativisht në buxhetin e ZKM-së.

Komisioni vlerësues pa anëtar teknik do të thotë se vlerësimi i ofertave nuk do të përmbajë në vete opinionin teknik.

Rekomandimi nr.4.

4.1. Blerja e pajisjeve duhet të bazohet në nevojat e vërteta të stafit. Kur mallrat të

pranohen, ato duhet të kontrollohen për nga kualiteti dhe të krahasohen me specifikacionin teknik.

- 4.2. Ne rekomandojmë që Departamenti i TI-së, para se të bëjë blerjen e pajisjeve, të përgatisë një plan adekuat dhe të bëjë shpërndarjen e këtyre pajisjeve/mallrave sa më parë që është e mundur, pas kontrollimit të tyre.
- 4.3. Të gjitha specifikacionet teknike duhet të përgatiten nga njësi përkatese teknike dhe komisioni i vlerësimit duhet të përbëhet nga anëtarë që zotërojnë kualifikimet e kërkuara.

Komentet e Menaxhmentit

Dosja për furnizime me inventarë e faktuar nga auditimi nuk është shkelje e LPP-së, sepse në kontratat afatgjate nuk bëhen zotimet totale për të gjitha furnizimet e mundshme por bëhet zotim i arsyeshëm, në mënyrë që për shkak të vazhdimësisë së proceseve mos të bllokohen të gjitha mjetet monetare.

E faturuara si gjetje, e renditur nën dy emërtime ZKM ZP 068/2007 “ Furnizim me pajisje të TI” ju njoftojmë se Zyra e Prokurimit ka procedura me tenderin për pajisje të TI, ku sasinë, arsyeshmërinë e sasisë dhe specifikat teknike i ka marrë nga Zyra e Administratës, zyrë kjo e cila në kuadër të planit të punës së saj bënë kërkesa të cilat kanë qenë shumë të arsyeshme, sepse ajo ka planifikuar që ndërkohë do të kemi shtim të stafit apo ndonjë defekt të riparueshëm në kompjuterët ekzistues, andaj për atë qëllim kemi marr disa kompjuterë më shumë. Prandaj kjo zgjedhje e Zyrës së Administratës dhe koordinimi me Zyrën e Prokurimit është shumë e qëlluar sepse na sjellë më pak probleme rreth procedimit të kohëpaskohshëm të tenderimeve për artikujt e njejt. Pra, bazuar në shkresën e auditorëve ju njoftojmë se kjo kritikë nuk ka bazë ligjore pranë LPP-së.

Dosja, përkatesisht specifikat teknike për automjetet e blera sipas auditorëve nuk është bërë nga njësi e transportit, por është bërë në koordinim të plotë në mes të njësisë së transportit dhe Zyrës së prokurimit pranë Kryeministrisë. Preferencë e kabinetit ka qenë lloji i automjeteve (xhipa 4*4 për shkak të përcjelljes së delegacioneve dhe sigurisë gjatë lëvizjeve).

Vlerësimi i ZAGJ – se

Mbeten konstatimet e auditorit ne raport pasi qe nuk ka dëshmi te mjaftueshme prej ZKM–se për te ndikuar ne mendimin e auditorëve për te gjeturat ne procedurat e shpenzimeve.

Te gjitha te gjeturat gjate punës janë diskutuar edhe me zyrtaret e ZKM –se te cilët janë përgjegjës për procedurat e shpenzimeve.

Ne planifikimin e prokurimit duhet te paraqitet vlere e përafërt e shpenzimeve qe do te bëhen gjate vitit, e jo vetëm ato qe do te zotohen ne fillim.

Ne blerjet e pajisjeve te teknologjisë informative ne raportin e auditorit nuk është cekur se ka shkelje te ligjit te prokurimit siç është cekur ne koment nga ZKM –ja, por ne ketë

raport është paraqitur sasia e mjeteve qe gjinden ne depo dhe nuk kane hyre ne funksion edhe pas 7 muajve.

Për koordinimin ne mes te zyrës se transportit dhe Zyrës se Prokurimit nuk kemi gjetur kurfar dëshmish gjate punës ne teren, por edhe tani nuk kemi kurfar dëshmi qe e mbështesin ketë koment nga ZKM – ja

5. Shpenzimet e Udhëtimit

Shpenzimet e udhëtimit rregullohen me Udhëzimin Administrativ të MSHP nr.2004/07 për Udhëtimet Zyrtare. Sipas këtij udhëzimi, udhëtimi zyrtarë paraqet lëvizjet të cilat kanë destinacion ose qëllim i cili i shërben përmbushjes së detyrave zyrtare në të mirë të Qeverisë së Kosovës dhe Shërbimit Publik të Kosovës. Pjesa tjetër e këtij udhëzimi përshkruan procedurat në realizimin e këtyre udhëtimeve zyrtare.

E gjetura

Shpenzimet për udhëtime jashtë vendit, sipas pasqyrave financiare të ZKM-së janë 294,883 Euro. Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se 40,231 Euro të regjistruara me kodin “Shpenzime Udhëtimi brenda Vendit” të cilat ishin për shpenzime udhëtimi jashtë vendit. Gjatë testimit të të lartpërmendurave, ne vërejtëm me sa vijon:

- Lënda, 123866, për 14,822 Euro nuk përmbante urdhëresa udhëtimi siç kërkohet me UA për udhëtime zyrtare jashtë vendit. Për më tepër, ne kemi vërejtur se shpenzimet në shumën 6,669 Euro ishin bërë për individ që nuk ishin punonjës të ZKM-së.
- Faturat ishin proceduar edhe pse nuk kishte bileta udhëtimi për lëndën 123866, ku shpenzimet nuk mbështeteshin me bileta udhëtimi për shumën 1,378 Euro.

Konkluzioni

ZKM kishte paguar për udhëtime jashtë vendit duke injoruar kështu kërkesat e UA 2004/07. Për sa i takon shpenzimeve për individ që nuk ishin të punësuar në ZKM, mund të konstatojmë se këtu nuk ka funksionuar kontrolli i brendshëm.

Rekomandimi nr. 5.

Ne rekomandojmë që menaxhmenti të vendos kontrolle për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, që të mos lejoj shpenzime pa u plotësuar të gjitha kërkesat sipas rregulloreve dhe udhëzimeve administrative përkatëse. Në fund, ZKM nuk duhet të paguaj për individ të cilët nuk punojnë në ZKM, pa një aprovim paraprak qeveritar.

Komentet e Menaxhmentit

Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit nuk kompensohen në bazë të Udhëzimit Administrativ nr 2004/7, prandaj vlera prej 40.231,00 , në këtë kategori janë shpenzime

jashtë vendit, mirëpo evidence është bërë në bazë të kodeve ekonomike të atëhershme të cilat kanë pësuar ndryshime në ndërkohë.

Për të gjitha shpenzimet e udhëtimit ekzistojnë kërkesat për udhëtime zyrtare për personat të cilët janë në marrëdhënie pune në ZKM. Mirëpo ka raste të shpenzimeve të udhëtimit – biletave për persona të cilët nuk janë në marrëdhënie pune në ZKM. Për faturat e paguara për këta persona ekzistojnë shpjegime plotësuese nga stafi menaxherial, dhe është i vërtetuar dokumentacioni për pagesën e tyre.

Vlerësimi i ZAGJ – se

Mbeten konstatimet e auditorit ne raport pasi qe nuk ka dëshmi te mjaftueshme prej ZKM –se për te ndikuar ne mendimin e auditorëve për te gjeturat ne shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit.

6. Menaxhimi i Pasurisë

Menaxhimi dhe regjistrimi i pasurisë publike rregullohet me Instruksioni Administrativ i MEF-it nr.2005/11 “Menaxhimi dhe regjistrimi i pasurive qeveritare” ndërsa sipas Nenit 10 – çdo Organizatë Buxhetore është e obliguar që në fund të çdo viti fiskal të kryej një inventarizim fizik për pasuritë e saj.

Të gjitha ndryshimet në numër ose në vlerë të pasurisë, të identifikuar gjatë inventarizimit duhet të reflektohen në të dy regjistrat, ai i kontabilitetit dhe atë të pasurisë.

Nëse stafi lëshon institucionin, ai/ajo duhet të kthehet të gjithë pasurinë e ZKM-së që ka në posedim.

E gjetura

Gjatë auditimit tonë bërë pasurisë së ZKM-së, ne kemi audituar procedurat e menaxhimit të pasurisë, për sa i takon pranimit, regjistrimit, mbrojtjes, riparimit dhe shlyerjes së pasurisë.

- Ne kemi vërejtur që regjistrimi i pasurisë në fund të vitit 2007 ishte i pakompletuar (automjetet ishin lënë jashtë) dhe se nuk kishte procedura për zhvlerësimin e pasurisë.
- Nuk ishte kryer harmonizim me Librin Kryesor të Thesarit (LKTH). LKTH tregon vetëm 4 automjete me një vlerë të përgjithshme prej 202,046 Euro, por ZKM ka 51 automjete dhe pasuri tjetër me një vlerë prej mbi 1000 Euro.
- Një numër i ish të punësuarve të ZKM-së, nuk kishin kthyer pajisjet; dy llaptop nuk ishin kthyer, llaptop Toshiba numër serik 94058755 dhe një Dell. Gjithashtu zyrtarët e mëparshëm të sigurimit, nuk kanë kthyer këmishat anti-plumb, me vlerë 5,712 Euro.

Konkluzioni

Regjistri i Pasurisë është jo i plotë dhe jo i përditësuar, kështu që është e pamundur që të sigurohet një vlerë e saktë për pasurinë e ZKM-së. Gjithashtu, ekziston mungesë kontrolli mbi menaxhimin e pasurisë, që si rezultat paraqitet se stafi që largohet nga ZKM, nuk i kthen pajisjet që janë në pronësi të ZKM-së.

Rekomandimi nr. 6.

Menaxhmenti duhet të sigurohet që regjistri i pasurisë është i përditësuar dhe rregullisht i mirëmbajtur. I gjithë stafi duhet të udhëzohet që të kthejnë të gjitha pajisjet me të cilat janë ngarkuar, atëherë kur ata lëshojnë organizatën.

Komentet e Menaxhmentit

Pajtohem me rekomandimin e zyrtarëve të auditimit lidhur me regjistrin e pasurisë. Është e vërtet se regjistri i pasurisë ka qenë ende i pa përfunduar, për shkakun se zyrtarja e pasurisë nuk ka arritur që të përfundojë futjen e të gjitha të dhënave në sistemin e bazës së të dhënave për regjistrimin e pasurisë. Programi është në zhvillim e sipër dhe se jemi duke u përpjekur që këto të dhëna të kompletohen sa më parë që të jetë e mundur.

Qëndron fakti se dy llaptop nuk janë kthyer edhe përkundër njoftimit me shkrim për kthimin e pasurisë së ZKM-së (ekzistojnë shkresat). Jemi duke marrë masa për kontaktimin e atyre personave për kthimin e mjeteve që janë pasuri e ZKM-së ose në të kundërtën do të hapen procedura tjera ligjore për kthimin e pasurisë.

Vlerësimi i ZAGJ – se

Entiteti është pajtuar me te gjeturën, andaj mbeten konstatimet e auditorit ne raport.

7. Menaxhimi Automjeteve

Zyra për menaxhimin e automjeteve është përgjegjëse për 51 automjete dhe nga ajo kërkohet të veproj në bazë të UA të MSHP nr. 2006/07 “Për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës” i cili përcakton kush ka të drejtë të shfrytëzoj automjetet. Neni 6.3 thekson që secili përdorues kërkohet të plotësoj fletën e udhëtimit, të shënoj kilometrat para nisjes dhe pas përfundimit të udhëtimit, destinimin, qëllimin, emrat e pasagjerëve dhe nënshkrimin e personit që përdorë automjetin.

Ekziston një normativë për shpenzime të karburantit për secilin automjet. Tenderi për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve ishte ndarë në 7 lote, sipas llojit të automjetit, ku secila kompani ka ofruar një listë me çmime për pjesët e automjeteve.

E gjetura

Gjatë auditimit të shpenzimeve për karburante, ne kemi krahasuar kilometrat e kaluara me shpenzimet për secilin automjet. Gjatë testimit të shpenzimeve për servisim dhe mirëmbajtje, ne kemi testuar procedurat që kanë të bëjnë me servisimin e automjeteve dhe kemi krahasuar çmimet e faturuara me specifikacionin teknik.

- Ne kemi llogaritur që shpenzimet për karburante, bazuar në kilometrat e kaluara (sipas normativit për shpenzime të karburantit), do duhej të ishin 110,161 Euro, megjithatë PF tregojnë 145,104 Euro. Kjo diferencë prej 34,943 Euro paraqiten për shkak se automjetet janë përdorur përderisa evidencë nuk është mbajtur.
- Nuk janë mbajtur shënime për automjetet e shfrytëzuara nga politikanët, ndërsa për stafin administrativ shënime janë mbajtur vetëm për sa i takon destinacionit, por jo për kilometrat e kaluara, qëllimin e udhëtimit si dhe për individët që kanë udhëtuar.
- Për kontrata servisimi dhe mirëmbajtje, ne kemi vërejtur diferenca në mes të kontratave dhe faturave. Mercedes Benz S (000 – KS – 003) është servisuar 5 herë gjatë vitit 2007 me një çmim prej 10,353 Euro. Fatura me numër rendor 1046 në vlerë prej 1,217 Euro dhe fatura me nr. rend. 845 në vlerë prej 7,568 Euro, artikuj të caktuar që janë faturuar, nuk ishin përfshirë në kontratë. Me faturën nr. 1558, 4 goma janë paguar 5,720 Euro, ndërsa në kontratë çmimi për një gomë është 432 ($4 \cdot 432 = 1,728$ Euro), diferenca është 3,992 Euro.

Konkluzioni

Mungesa e monitorimit dhe kontrollës në lidhje me shfrytëzimin e automjeteve dhe shpenzimeve për to, siç kërkohet me UA 2006/07, ka rezultuar që ZKM të mbi shpenzoj buxhetin për transport.

Rekomandimi nr. 7.

Menaxhmenti duhet të vendos kontroll më të mire për të monitoruar përdorimin e automjeteve dhe shpenzimet për to. Faturat duhet të kontrollohen dhe të verifikohen me specifikacionin teknik, për të siguruar që vetëm artikujt e kërkuar (e saktë) dhe çmimet e kontraktuara blihen dhe paguhen.

Komentet e Menaxhmentit dhe Vlerësimi i ZAGJ-së

Qëndron e gjetura se nuk është bërë një analizë e hollësishme lidhur me shpenzimet e karburanteve për 100 km, edhe pse kemi një pasqyrë të saktë lidhur me numrin e km dhe sasinë e karburanteve të shpenzuara për secilin automjet për çdo muaj dhe lidhur me këto ekzistojnë raporte mujore me shkrim.

Vlerësimi i ZAGJ – se

Entiteti është pajtuar me te gjeturën, andaj mbeten konstatimet e auditorit ne raport.

8. Menaxhimi i Parasë së Imtë

Rregulli Financiar dhe Udhëzimi i Thesarit – 02, Shpenzimi i Parasë Publike, Neni 9.3 vendos rregullat për përdorimin e parasë së imtë. Paraja e imtë nuk duhet të përdoret për shpenzime që mund të paguhen përmes procesit të shpenzimeve normale dhe **nuk duhet të përdoret për** – shërbime komunale; mallra dhe shërbime me vlerë mbi 100 Euro; pagesa apo beneficione për personelin; shpenzime udhëtimi apo për konferenca, si dhe si pagesa avansi për stafin për udhëtime.

E gjetura

Ne kemi vërejtur shembujt vijues të cilët nuk janë të lejueshëm sipas Rregullit Financiar dhe Udhëzimit të Thesarit – 02, Shpenzimi i Parasë Publike, Neni 9.3).

- Ndarje te faturave kur vlera totale tejkalonte 100 Euro;
- Tejkallim nga ana e pagesave të pragut prej 100 Euro;
- Pagesa për shpenzime komunale;
- Pagesa për shpenzime të karburanteve;
- Pagesa për kuponë pa datë;
- Pagesa për shpenzime te udhëtimin,
- Pagesa për shpenzime te telefonit

Konkluzion

ZKM nuk ka një kontrolle adekuate të brendshme për menaxhimin e parasë së imtë, duke rritur kështu rrezikun e keqpërdorimit. Ajo e ka thyer kufirin e epërm për shpenzim të parasë së imtë dhe ka përdorur atë për pagimin e shpenzimeve të ndryshme të cilat nuk janë të lejueshme.

Rekomandimi nr. 8.

ZKM rekomandohet të zbatohet në tërësi Rregullin Financiar dhe Udhëzimin e Thesarit – 02, në lidhje me nevojat e saj dhe për përdorimin e parasë së imtë.

Komentet e Menaxhmentit

Të gjeturat e auditorit janë të sakta siç është cekur në raport, mirëpo bazuar në specifikat e rasteve konkrete në praktikë të cilat domosdo duhet të realizohen, pagesat e bëra kanë pasur specifikat, për çka kemi pasur kontakte të rregullta me Thesarin.

Pagesa e shpenzimeve të konkursit në mediat e komuniteteve të cilat nuk kanë pranuar në llogari pagesa, kanë qenë mbi limitin e kërkuar. Pagesa e shpenzimeve për manifestime, regjistrimi i disa automjeteve me urgjencë për shkaqe të ndryshme, si dhe shpenzime të paparapara nuk kanë pasur mundësi të realizohen përmes llogarisë bankare.

Vlerësimi i ZAGJ – se

Entiteti është pajtuar me te gjeturën, andaj mbeten konstatimet e auditorit ne raport.

ANEKSI

PASQYRAT FINANCIARE TE ZKM –SE PËR VITIN 2007



**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCJE SAMOUPRAVLANJA**

**OFFICE OF THE PRIME MINISTER
ZYRA E KRYEMINISTRIT
URED PREMIJERA**

RAPORTI VJETOR FINANCIAR

Për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2007

Prishtinë; Janar 2008

II

Neni 8. DEKLARATË PËR PREZENTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **Lulzim Ismajli, Drejtor i Thesarit**
Nga: **Fitim Krasniqi Sekretar i Përhershëm**

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiar të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2007 të cilat janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë 2003/02 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e pasqyrave financiare të Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës të **organizatës buxhetore** për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2007.

Ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:
Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësinë apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiarë lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.

Nuk ka llogari bankare të BKK-së përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiarë dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2007.

Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare, në rast se do të shkeleshin.

Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur.

Të gjitha huat për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.
Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2007 të **Zyrës së Kryeministrit.**

Nënshkruar: _____

Zahir Bajrami Drejtor i ZBF-së

Datë: 29.01.2008

Nënshkruar: _____

Fitim Krasniqi Sekretar i Përhershëm

Datë: 29.01.2008

Përmbledhja

1. Raporti i buxheti
 - 1.1 Raporti i Buxhetit
 - 1.2 Raporti i buxhetit duke përfshire edhe grantet donatore
 - 1.3 Raporti i Ekzekutimit të buxhetit
 - 1.4 Raporti i pagesave sipas programeve
 - 1.5 Raporti sipas kodeve ekonomike
2. Pasqyra e pranimiit dhe Pagesave në para të gatshme
3. Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit
4. Shpalosja e shenimeve
 - 4.1 Ndarjet e fondit të Përgjithshëm,
 - 4.2 Grantet e përcaktuara të donatorve
 - 4.3 Pagat dhe Meditjet
 - 4.4 Mallrat dhe Sherbimet
 - 4.5 Suvencionet dhe transefret
 - 4.6 Paisjet
 - 4.7 Harmonizimi i ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit
 - 4.8 Grantet dhe Ndihamat
 - 4.9 Pasqyra e faturave _obligimeve
 - Huat dhe Avanset
 - Asetet Jo-financiare

Raporti i Buxhetit

Buxheti i Zyrës së Kryeministrit për vitin 2007, në bazë të rishikimit ka qenë më i madh për 11.53%, kurse ai përfundimtar për 12.12%, ndryshimi është si rezultat i pranimeve që janë bërë nga Fondi Rezervë i Ministrit të Financave në bazë të Vendimeve të Qeverisë. (Shife tabelen e Raportit të Buxhetit Tabela 1)

Buxheti duke përfshirë edhe grantet donatore, në bazë të rishikimit është për 14.06% më i madh se gjendja fillestare, kurse në bazë të raportit përfundimtar(SIMFK) është më i madh për 21.04%.Ndryshimi i rritjes është 6.11%,

Grantet e mbrendshme shenojnë një rritje nga 70.000.00 në 274.034.46 euro. Kjo ka të bëjë vetëm me projektin e ndertimit të shtëpive për Invalidët e luftës në bazë të vendimit të Qeverisë.(Shifë tabelen e Raportit të Buxhetit me Grantet Donatore) Tabela 2

Ekzekutimi i Buxhetit në bazë të krahasimit më rishikim është 0.22% më i madh, kurse në bazë të raportit përfundimtar 82.80% ose 17.20% më i ultë.

Granti i përgjithshëm është shfrytëzuar për 85.35% kurse Grantet e Donatorve 50.75% (shife tabelen Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit) Tabela 3

Në kuadër të zyrës së Kryeministrit prej fillimit të vitit kanë funksionuar pesë programe kurse nga tetori i vitit 2007 edhe programi 810 i Zyrës për Qeshtje jorezidente i cili me vendim të Qeverisë është bartur nga Ministëria e Kulturës, dmth në ZKM kanë funksionuar këto kode:

ZKM10600,

